

Festivali Folklorik Kombëtar, Gjirokastër 2000

Në Gjirokastër, prej 20 deri më 24 shtator 2000, u mbajt Festivali Folklorik Kombëtar. Në të morën pjesë grupe të ndryshme folklorike me këngë e valle nga të gjitha viset shqiptare të Ballkanit dhe nga diaspora. Kosova u përfaqësua me dy grupe prej 100 artistësh popullorë nga Rugova, Vrrini e Vushtria, si dhe nga Karadaku, Hasi e Prishtina. Në këtë festival, të tetin me radhë pas vitit 1949, morën pjesë edhe studiuesit e folklorit dhe të etnologjisë të Institutit Albanologjik të Prishtinës.

Gjirokastra u bëri pritje madhështore artistëve popullorë nga Kosova. Ishte pritje që nuk mbahet mend në Sheshin e Çerqizit, ku kosovarët e nisën këngën e vallen posa mbërrinë në këtë qytet të lashtë, qendër universitare dhe vendlindje e njerëzve të mëdhenj të kombit. Në programin garues, ata morën pjesë në natën e fundit të Festivalit. Valltarë, këngëtarë dhe instrumentistë u pritën me duartroktije të gjata. Rugovasit u veçuan nga Juria për pikën e kostarëve dhe u shpërblyen. U dallua edhe Karadaku dhe vallet e tyre epike të burrave, të cilët po ashtu u shpërblyen.

Që nga nata e parë e konkurrimit, kur doli në skenë Prefektura e Kukësit (Kukës, Has, Tropojë) e deri në mbylljen e Festivalit, binte në sy përpjekja e artistëve popullorë për të paraqitur vlera të hershme etnokulturore e kombëtare. Përpjekje të tilla i shihje te këngëtarët e valltarët nga Fieri, Korça, Dibra, Tirana, Vlora, Berati, Shkodra, Durrësi, Lezha, Elbasani, Gjirokastra, Çamëria dhe nga përfaqësuesit e shqiptarëve në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në Jurinë e Festivalit ishin: Thoma Gaçi (artist i merituar), Vaso Tole (muzikolog), prof. Spiro Shkurti (etnolog), Irimi Qiriako e Hysni Zela (këngëtarë) Besim Jazexhiu dhe Zana Çela.

Në këtë festival, sipas prof. Ramazan Bogdanit, u luajtën mbi 170 valle, që është pasuri e madhe edhe për popujt e mëdhenj. Të veçanta ishin *Vallja e iriqit* dhe *Kërcimi i dragoit*. Besim Zekthi, kryevalltar dhe veteran, ia dorëzoi xhamadanin brezit të ri të Rexhep Çelikut. Në Festival ishin edhe Xhevit Metani, veteran i ekzekutimit dhe pjesëmarrës në katër festivale, Xhemali Toçilla, lodërtar i shquar, Gjokë Prelë Nokaj, lahutar 92 vjeç.

Festivali është përgatitur 9 muaj. Morën pjesë 16 grupe konkurruese. Janë përzgjedhur grupet më të mira lokale. Përzgjedhës ishin specialistët e valleve, të veglave muzikore, të teksteve poetike dhe të veshjeve

popullore. Kjo barrë ra sidomos edhe mbi Institutin e Kulturës Popullore. Organizuese e Festivalit ishte Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sporteve, kurse bartëse e organizimeve Qendra Foklorike Kombëtare dhe drejtori i saj, Ermir Dizdari. Kosova mori pjesë me ftesë të kësaj ministrie. Departamenti i Kulturës i Kosovës ia besoi përzgjedhjen Institutit Albanologjik të Prishtinës. Në grupin përzgjedhës të teksteve, të veshjeve, të valleve dhe të këngëve popullore ishin dr. Zymer Neziri, dr. Ukë Xhemaj e Bahtir Sheholli.

Me artistët popullorë ishte edhe dr. Sadri Fetiu, drejtor i IAP-it.

Festivali Foklorik Kombëtar ishte ngjarje e madhe etnokulturore e Ballkanit dhe me peshë të veçantë në mozaikun etnokulturor të Mesdheut dhe të Evropës.

Zymer NEZIRI

Në Degën e Etnologjisë u mbrojt disertacioni i parë i doktoratës

Në Degën e Etnologjisë të Institutit Albanologjik të Prishtinës u mbrojt disertacioni i parë i doktoratës në fushën e shkencës së etnologjisë, nga kandidati mr. Ukë Xhemaj, hulumtues i pavarur i kësaj dege të IAP-it. Disertacionin e doktoratës, me titull *Podguri-etnokultura shqiptare në kontinuitetin historik*, e mbrojt më 9.9.1999, para Komisionit: akademik prof. dr. Mark Krasniqi, dr. Drita Statovci, këshilltare shkencore, dr. Rexhep Munishi, këshilltar shkencor.

Ky disertacion i doktoratës i kandidatit mr. Ukë Xhemaj u vlerësua lart nga komisioni. Ai është një monografi e mirëfilltë shkencore etnologjike, ku përfshihet hapësira, jeta dhe kultura shqiptare e kësaj krahine në rrethin e Pejës. Qasja serioze, këmbëngulësia për t'u argumentuar secila tezë e hipotezë e shtruar në këtë punim, duket se ishte synimi parësor i kandidatit, thuhet në vlerësimin e komisionit. Ky është një kontribut me rëndësi për etnologjinë dhe për studimet albanologjike.

Zymer NEZIRI